



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2023:180614

Datë: 18.04.2024

Numri i dokumentit: 05591040

P.nr.2023:180614

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Samedin Cena, me zyrtarin ligjor Fatlind Kryeziu, në çështjen penale kundër të akuzuarit L.SH., nga fshati..., Komuna e Gjakovës për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve në vazhdimësi nga neni 314, par.1 lidhur me par.6 dhe me nenin 77 të KPRK-së, i akuzuar nga Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm sipas Aktakuzës me numër PP/II.nr.830/23 të datës 22.08.2023, në bazë të nenit 357 par. 1 nën par. 1.3 të KPPRK-së si dhe nenit 11 dhe 15 të Ligjit nr.06/L-009 për Ndërmjetësim, jashtë seance, me datë 18.04.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET Marrëveshja për ndërmjetësim me numër Nd.nr.34/24 e datës 18.04.2024 e lidhur në mes të akuzuarit L.SH., nga fshati ., Komuna e Gjakovës dhe të dëmtuarës K. - Divizioni i Rrjetit në Gjakovë.
- II. HUDHET Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.830/23 e datës 22.08.2023 dhe PUSHOHET procedura penale ndaj të akuzuarit L.SH., nga fshati ., Komuna e Gjakovës për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve në vazhdimësi nga neni 314, par.1 lidhur me par.6 dhe me nenin 77 të KPRK-së për shkak se palët kanë arritur marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit.
- III. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur Aktakuzën PP/II.830/23 të datës 22.08.2023 kundër të akuzuarit L.SH., nga ... Komuna e Gjakovës për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve në vazhdimësi nga neni 314, par.1 lidhur me par.6 dhe me nenin 77 të KPRK-së.

Gjykata Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm më datën 17.04.2024, ka mbajtur shqyrtimin fillestar në këtë çështje penale në të cilin shqyrtim ishin prezent Prokurori i Shtetit Shqiponja Jupa, pala e dëmtuar K.– Sh.a – Divizioni në Gjakovë, përfaqësuar sipas autorizimit nga T.G dhe i akuzuari L.SH.,

Gjatë këtij shqyrtimi fillestar i akuzuari L.Sh. deklaroi se është i gatshëm që t’ia kompensojë dëmin dhe propozon që lënda të dërgohet në procedurën e ndërmjetësimit.

Prokurori i shtetit Shqiponja Jupa deklaroi se nuk e kundërshton propozimin për dërgimin e lëndës në procedurën e ndërmjetësimit.

Pala e dëmtuar K...Sh.A – Divizioni në Gjakovë deklaroi se nuk e kundërshton propozimin për dërgimin e lëndës në procedurën e ndërmjetësimit.

Gjykata pasi mori mendimin e Prokurorit të shtetit Shqiponja Jupa dhe palës së dëmtuar K..SH.A - Divizioni në Gjakovë, aprovoi propozimin e të akuzuarit L.SH., që kjo çështje juridiko penale të dërgohet në organin e ndërmjetësimit dhe është ndërprerë shqyrtimi, ndërsa janë udhëzuar palët që këtë çështje ta zgjidhin në procedurën e ndërmjetësimit.

Me datën 18.04.2024, në Gjykatën Themelore në Gjakovë, në prezencën e ndërmjetësuesit Vlora Deva, është lidhur marrëveshja për zgjidhjen e ndërmjetësuar ndërmjet të akuzuarit L.SH., dhe të dëmtuarës K.. SH.A – Divizioni në Gjakovë.

I akuzuari L.SH., (pala B) ka deklaruar se i kërkon falje palës A lidhur me dëmin e shkaktuar në vlerë prej 391.8 Euro, e pranon borxhin ndaj palës A, mirëpo kërkon që këtë borxh t’i mundësojë ta paguaj me tri këste.

Ndërsa e dëmtuara K.. SH.A (pala A) deklaroi se pajtohet që borxhi të paguhet me tri këste në atë mënyrë që pagesa të bëhet me përshkrimin rikthimi i humbjeve për shifrën DGJ267 dhe se meqenëse u arrit kjo marrëveshje pala A tërhiqet nga ndjekja penale.

Ndërmjetësuesja Vlora Deva me Vendimin Nd.nr.34/24 të datës 18.04.2024 ka pranuar marrëveshjen e palëve për zgjidhje të ndërmjetësuar.

Andaj, gjykata duke vepruar konform dispozitave të nenit 15 të Ligjit për ndërmjetësim e aprovoi këtë marrëveshje pasi që të njëjtën e vlerësoi se është lidhur me vullnetin e plotë të palëve në konflikt dhe në pajtim me ligjin në fuqi. Konform nenit 15 të Ligjit për Ndërmjetësimin me datën e pranimit nga gjykata përkatësisht nga data 18.04.2024, e njëjta do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Gjykata duke u bazuar në provat si më lartë dhe në bazë të nenin 357 par.1 nënpar.1.3 të KPPRK-së dhe nenit 11 të Ligjit nr.06/L-009 për Ndërmjetësim vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.2023:250763,, me datë 18.04.2024

Zyrtari ligjor  
Fatlind Kryeziu

Gjyqtari  
Samedin Cena

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmes të kësaj gjykate.